

RREZIQE TË MUNDSHME PËR FËMIJËT



EKSPOZIMI NDAJ MATERIALEVE TË PAPERSHATSHME

Ekziston rreziku që fëmijët të shohin materiale të papërshtatshme ku përfshihen ato pornografike, me shfaqje dhune, urrejtje, apo që nxitin aktivitete të rrezikshme ose të paligjshme.

Disa faqe promovojnë këto lloj materiale. Këto mund të shihen nëpërmjet rrjeteve të ndryshme apo të dërgohen me anë të e-mailit. Materiale të tilla mund të dalin edhe në mënyrë të paqëllimshme, nëpërmjet kërkimit për vende, njerëz apo çështje të ndryshme. Fëmijët duhet të dinë për teknikat e kërkimit të sigurt. Prindërit duhet të dinë ku të raportojnë probleme të tilla dhe si të trajtojnë materialin e papërshtatshëm.

RREZIKU FIZIK

Ky rrezik lidhet edhe me internetin. Fëmija juaj mund të takojë fizikisht një person, i cili në internet hiqet si dikush tjetër. Është e rëndësishme që fëmija të dijë se informacioni personal nuk duhet t'i jepet askujt në internet. Ndothë që pedofilët përdorin dhomat biseduese, apo u dërgojnë mesazhe konfidenciale fëmijëve, për t'i takuar më pas.

REKLAMIM I PADËSHIRUAR DREJT FËMIJËVE

Komercializimi i internetit është në rritje. Niveli i lartë i komercializimi vërehet në faqe të ndryshme, në postën elektronike, marketingun online, madje duke marrë edhe formën e lojërave të bixhozit online.

Faqet mashtruese të internetit janë krijuar për t'u vjedhur njerëzve para dhe mundësi. Për shembull, disa faqe interneti që duken sikur u përkasin bankave, u kanë marrë personave të dhëna të kartës së kreditit. Për shkak të natyrës bindëse dhe nxitëse të këtyre faqeve, fëmijët mund të vënë veten apo familjen në rrezik financiar duke dhënë të dhëna të kartave të kreditit të prindërve të tyre. Rregulli bazë në këtë rast, është që nëse diçka duket shumë e mirë për të qenë e vërtetë, me shumë mundësi nuk është e tillë.

NGACMIMET APO SHARJET

Këto rreziqe mund të merren nëpërmjet shërbi- meve të internetit si: postë elektronike, dhomat biseduese, faqet e internetit, mesazhet nëpërmjet internetit, etj. Gjithashtu, mund të merren edhe nëpërmjet teknologjisë së telefonisë celulare. Këto rreziqe përfshijnë gjithashtu edhe ofendimet, mesazhet e padëshiruara dhe shpifjet.

PËRDORIMI

Disa faqe interneti i shtyjnë njerëzit të plotësojnë formularë me informacion për emrin, adresën e e-mailit, gjininë, numrin e telefonit, etj. Duke dhënë këtë informacion online, mund të bëheni shënjestër e mesazheve elektronike të padëshiruara dhe/ose viruseve. Këto mund të përbëjnë edhe shkelje e ligjeve të privatësisë.

INFORMACIONI PERSONAL DHE PRIVATËSIA

Ashtu siç nuk i jepni informacion një personi në rrugë, të njëjtën gjë duhet të bëni edhe në internet.

Krijimi i faqeve të internetit mund të jetë një eksperiencë argëtuese dhe edukuese për fëmijët. Megjithatë, ekziston rreziku që fëmijët mund të vendosin adresën e shtëpisë dhe të dhëna personale duke përfshirë foto personale të tyre, familjarëve apo fëmijëve të tjerë. Kjo paraqet rrezikun që ky material të përdoret në mënyrë të papërshtatshme. Për më tepër, vendosja e adresave të e-mailit të fëmijëve në faqe interneti mund të sjellë marrjen e materialeve të papërshtatshme.

MESAZH I PAVËRTETË

Shumë faqe në internet e shtrembërojnë të vërtetën, mund të jenë mashtrime ose të pasakta. Disa faqe raciste pretendojnë se tregojnë të vërtetën për çështje komplekse sociale, kulturore apo historike në mënyrë që të duken të besueshme dhe bindëse. Këto faqe njihen si shumë aktive në shitjen e produkteve apo rekrutimin e individëve.

SPAM

Spam është termi që përdoret për mesazhet elektronike të padëshiruara që gjejmë në postën tonë, i dërguar nga individë apo organizata. Mund të përmbajë viruse apo përmbajtje pornografike. Spam po përhapet vazhdimisht dhe përbën një shqetësim për këdo që ka një adresë e-maili. Fëmijët duhet t'i dallojnë dhe fshijnë ato pa i hapur!

VIRUSET

Teksa e-maili është një mënyrë shumë e dobishme komunikimi, rreziqet përfshijnë e-maillet e padëshiruara nga dërgues të panjohur që mund të

përmbajnë viruse apo adresa që të dërgojnë në faqe të infektuara me viruse.

KOMUNIKIMI

Teknologjitë e internetit të tilla si e-mail, dhomat biseduese, forumet, konferencat elektronike, apo të tjera janë mjete efektive komunikimi. Pajisjet që mundësojnë internet si celularët, tabletat, etj, mund të përdoren për shkëmbime mesazhesh, fotosh, etj. Megjithatë, ekzistojnë disa rreziqe që lidhen me përdorimin e këtyre teknologjive:

- E-maillet mund të përmbajnë viruse apo mesazhe të padëshiruara;
- Mesazhet tekst mund të përdoren për të njëjtën arsye;
- Në dhomat biseduese mund të kemi rreziqe të njëjta. Në disa dhoma biseduese njerëzit mund të vendosin identitetet e rreme;
- Në disa raste, fëmijët mund të ekspozohen përballë një rreziku fizik duke takuar dikë që e takojnë në dhomat biseduese



NËSE KENI PYETJE

Kujdesi ndaj klientit pranë jush në çdo moment.

Telefononi në **142**.

Informohuni më tej si të lundroni të sigurt në internet përmes faqes zyrtare të ONE Telecommunications:

one.com.al/kompania/guide-udhezuese/

One

ÇDO DITË MË MIRË

PËRMBLEDHJE SE ÇFARË DUHET TË BËJMË PËR TË PASUR INTERNET TË SIGURT

Interneti ofron një numër të madh mundësish për familjen tuaj. Komunikimi i vazhdueshëm, kërkimi i materialeve dhe publikimeve online hap një botë të madhe kërkimore dhe argëtuese për fëmijët e të gjitha moshave. Megjithatë, njësoj si në botën reale ekzistojnë probleme dhe rreziqe të mundshme që lidhen me përdorimin e internetit. Duke krijuar një strategji të internetit të sigurt mund t'i mbronin fëmijët tuaj kur ata janë online. Ekzistojnë katër mënyra kryesore për ta arritur këtë:

- edukimi
- nxitja dhe mbështetja
- bërja e komjuterit të sigurt
- mbikëqyrja

Përdorimi i të katër mënyrave së bashku do t'ju japë rezultatet më të mira. Qëllimi nuk është vetëm t'i mbrojmë fëmijët por edhe t'i ndihmojmë ata të marrin vendimet e duhura kur ndeshen me situata të rrezikshme online.



SI MUND TË MBAJMË TË SIGURT FËMIJËT GJATË PËRDORIMIT TË INTERNETIT

One

ÇDO DITË MË MIRË

GUIDË UDHËZUESE



SI MUND TË MBANI TË SIGURT FËMIJËT GJATË PËRDORIMIT TË INTERNETIT

Sot, pajisjet teknologjike dhe interneti janë një pjesë e rëndësishme e jetës tonë. Me hapat gjigantë të zhvillimit teknologjik, ajo që dje ishte e pamundur, sot është e domosdoshme. Pjesë e këtij zhvillimi janë edhe telefonat celularë. Këto janë caq të përhapur sa lehtësisht harrohet sa teknologji e sofistikuar dhe e fuqishme është. Bashkë me ndryshimet pozitive vijnë edhe përgjegjësitë dhe rreziqet e mundshme. Ne në ONE Telecommunications, përpiqemi të minimizojmë rreziqet në të gjitha mënyrat, përfshirë edhe këtë guidë për përdorimin e sigurt të internetit. Kjo guidë këshillon fëmijët dhe prindërit, si dhe u jep informacion këtyre të fundit si mund t'i mbajnë fëmijët e tyre të sigurt në përdorimin e internetit. Kjo guidë, gjithashtu bën një ndarje sipas grupmoshave të fëmijëve për rreziqet që mund të shfaqen për secilën grupmoshë dhe mënyrat që mund të ndjekë prindi ose kujdestari për të zvogëluar këto rreziqe.



KËSHILLA PËR PRINDËRIT

Posta elektronike është shndërruar në pjesë të jetës. Ajo siguron komunikim të çastit dhe mundësi për të bashkëlidhur foto, dokumente, detyra, etj.

- Informohuni për rreziqet që mund t'u vijnë fëmijëve nga dhe gjatë përdorimit të internetit.
- Flisni me fëmijët tuaj. Pyetini fëmijët se çfarë faqesh vizitojnë online dhe kush janë miqtë e tyre.
- Mësojini fëmijëve sigurinë. Sigurohuni që fëmijët tuaj të dinë si mund t'i shmangin rreziqet. Asnjëherë të mos postojnë ftesa, informacion personal dhe të mos takojnë të panjohur.
- Ndihmojini fëmijët që të shohin informacionin online me sy kritik. Jo çdo gjë që shfaqet në internet është e vërtetë. Mësojuni atyre të bëhen përdorues të zgjuar të informacionit në internet.
- Trajtojeni informacionin tuaj online me sy kritik. Fëmijët tanë shohin gjithçka që bëjmë. Nëse nuk dëshironi që fëmijët tuaj të bëjnë si ju në internet, ju duhet ta rimendoni mënyrën e trajtimit të informacionit tuaj.
- Sigurohuni që t'i mbani të hapura kanalet e


komunikimit. Nëse fëmijët tuaj mendojnë se ju do t'ua merrni pajisjet kompjuterike apo do t'i qortoni nëse ju tregojnë diçka që do t'ju mërzisë, atëherë ata nuk do t'ju drejtohen kur të kenë vërtet nevojë.

- Vazhdimisht kontrolloni historikun e internetit në kompjuter apo celular. Kjo do t'ju ndihmonte të mësonit se çfarë faqesh frekuenton fëmija juaj gjatë përdorimit të internetit.
- Krijoni në kompjuter “përdorues të veçantë” për fëmijët tuaj, duke përcaktuar edhe kufizime përdorimi.
- Jetoni botën e tyre. Shkarkoni muzikë, luani një lojë online, krijoni profilin tuaj në rrjete sociale. Fëmija juaj jo vetëm që do t'i vlerësojë këto, por edhe ju do ta kuptoni çfarë trajtohet.
- Raportoni aktivitetet të dyshimta tek autoritetet përgjegjëse dhe Alo 116, Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë.



KËSHILLA PËR FËMIJËT PËR TA BËRË LUNDRIMIN NË INTERNET MË TË SIGURT

- Asnjëherë mos i tregoni atyre që njihni online numrin tuaj të telefonit, adresën e shtëpisë apo emrin e shkolles, përveç rasteve kur prindi apo kujdestari juaj e lejon diçka të tillë.
- Gjithmonë jini të kujdesshëm në dhomat biseduese (chat rooms) online. Edhe nëse dhoma tregon se kjo është vetëm për fëmijë, nuk mund të dihet nëse të gjithë aty janë fëmijë. Mund të jetë një i rritur apo fëmijë më i rritur që përpriqet t'ju mashtrorë.
- Asnjëherë mos dërgoni foto apo të dhëna lidhur me identitetin tuaj, pa u këshilluar më parë me prindin apo kujdestarin tuaj.
- Gjithmonë pyesni prindin ose kujdestarin nëse mund të frekuentoni dhomat biseduese (chat rooms).
- Asnjëherë mos lini takim me persona të tjerë, përveç rasteve kur prindi/kujdestari vjen me ju në takim në një vend publik. Personat që mund të kontaktoni online jo gjithmonë janë ata që mendojnë ju.
- Asnjëherë mos hapni materiale bashkëlidhur e-maileve, përveç rasteve kur vijnë nga dikush që e njihni dhe i besoni. Ato mund të përmbajnë viruse dhe programe të tjera që mund të dëmtojnë informacionin apo programet në kompjuterin tuaj.
- Fjalëkalimin gjithmonë mbajeni për vete dhe mos ua tregoni të tjerëve.
- Asnjëherë mos ju përgjigjini mesazheve sugjer-



uese të pakëndshme dhe gjithmonë tregojani prindit/kujdestarit nëse merrni të tilla.

- Gjithmonë qëndroni jashtë faqeve që tregojnë se duhet të jeni mbi 18 vjeç. Paralajmërimi vendoset për t'ju mbrojtur ju.
- Gjithmonë kini parasysh se, nëse dikush ju bën një ofertë që duket shumë e mirë për të qenë e vërtetë, me shumë mundësi është mashtrim.



FËMIJËT DHE INTERNETI

Sot, fëmijët vihen në kontakt me internetin në një moshë shumë të vogël dhe në vende të ndryshme. Këtu përfshihet:

- **SHKOLLA** - Kompjuterat mund të gjenden në nivele të ndryshme të sistemit arsimor;
- **SHTEPIA** - Shumë shtëpi kanë kompjutera personalë me akses në internet;
- **SHOKËT** - Nëse fëmija juaj nuk ka akses në internet në shtëpi, është shumë e mundur që një

nga shokët e tij të ketë;

- **BIBLIOTEKAT** - Bibliotekat kanë kompjutera të lidhur në internet për përdorim nga klientët;
- **QENDRAT E AKSESIT PUBLIK** - Vende publike ku njerëzit mund të kenë akses në internet;
- **PAJISJET E LËVIZSHME** - Telefonat celularë apo tabletat mund të sigurojnë akses në internet.

Fëmijët mund të kenë akses në internet. Për këtë arsye duhet t'i përgatisni fëmijët tuaj për internetin e sigurt, njësoj si dhe për çështje të tjera si: siguria ndaj zjarrit, ujit, siguria në rrugë, etj. Përgatitja e një strategjie të internetit të sigurt për fëmijët tuaj zvogëlon rrezikun e krijimit të problemeve.

ÇFARË BËJNË FËMIJËT E MOSHËS 5-7 VJEÇ NË INTERNET

Parashkollorët janë mjaftueshëm të rritur për të lundruar në internet dhe për të mësuar rreth kompjuterit. Fëmijët që nga mosha pesë vjeç mund të vizitojnë faqet e internetit për fëmijë bashkë me ju dhe të mbajnë korrespondencë e-maili me familjarët dhe miqtë.



ÇFARË MUND TË BËJNË PRINDËRIT

- Të kontrollojnë mirë faqet e përshtatshme për fëmijët e vegjël. Ju duhet të jeni të përgjegjshëm për përzgjedhjen vetëm të atyre faqeve që mund të vizitohen nga fëmijët e kësaj moshe.
- Rekomandohet një mbikëqyrje e afërt.
- Zgjidhni faqe dhe vendosini ato si shënime (bookmark) për fëmijët e vegjël.
- Përdorni zonat e sigurta për këtë grupmoshë, veçanërisht kur ata fillojnë shkollën dhe mund të bëjnë vetë veprime të tjera.
- Kufizoni korrespondencën me e-mail vetëm me disa anëtarë të familjes dhe familjarë që ju i keni aprovuar.
- Përdorni filtra për të kufizuar aksesin aksidental në materiale të papërshtatshme.

ÇFARË BËJNË FËMIJËT E MOSHËS 8-11 VJEÇ NË INTERNET

Që prej moshës tetë vjeç, fëmijët interesohen të zbulojnë më tepër rreth internetit, bisedave apo korrespondencave online. Disa fëmijë mund të fillojnë të kërkojnë pavarësinë e tyre dhe të shohin materiale të ndaluara. Ata në mënyrë të vazhdueshme mësojnë dhe kuptojnë ndryshimin ndërmjet një reklame dhe një materiali tjetër. T'u flasësh fëmijëve për informacionin komercial dhe mënyrat se si duhet trajtuar ai, i ndihmon ata. Aftësitë dhe pavarësia e tyre vazhdon e rritet, por duke e kthyer kërkimin në internet një aktivitet familjar, ju mund të keni një mbikëqyrje më nga afër.

ÇFARË MUND TË BËJNË PRINDËRIT

- Përfshihuni në mënyrë aktive në përdorimin e internetit nga fëmijët;
- Flisni për sjelljen e sigurt online dhe diskutoni pse kjo është e nevojshme;
- Kontrolloni dhomat biseduese që fëmija dëshiron të frekuentojë;
- Shihni mundësitë e përdorimit të filtrave për të bllokuar aksesin në faqe të ndryshme;
- Përdorni metoda kërkimore të hartuara për t'u përdorur nga fëmijët;
- Mbajeni kompjuterin në një vend të përshtatshëm në shtëpi që të mund të kontrolloni përdorimin nga fëmijët;

ÇFARË BËJNË FËMIJËT E MOSHËS 12-17 VJEÇ NË INTERNET

Interneti shndërrohet në një mjet shumë të vlefshëm për detyrat dhe projektet e adoleshentëve. Në të njëjtën kohë ata bëhen më të pavarur dhe më të sigurt në vete, duke kërkuar më tepër liri dhe duke u influencuar më tepër. Kontaktet e tyre online kanë tendencë të rriten. Disa mund të sfidojnë përdorimin e filtrave dhe të përpriqen të shohin materiale të ndaluara. Shumë kanë njohuri të mira të internetit dhe përpriqen të piratojnë sisteme dhe kuptojnë programimin bazë kompjuterik. Megjithatë, ata janë më në gjendje të dallojnë reklamën nga materialet e tjera dhe i kuptojnë teknikat bindëse.

Shumë adoleshentë më të rritur mund të krijojnë dhe të menaxhojnë programe kompjuterike. Përdorimi i internetit nga ana e tyre përfshin kërkimet shkollore, kërkime pune, komunikim global dhe njohuri teknike në rritje. Këto njohuri në rritje mund të krijojnë problem për ta, nëse zbulojnë mënyra apo metoda për të hyrë apo dëmtuar sisteme private.

ÇFARË MUND TË BËJNË PRINDËRIT

- Ruani kontaktet me fëmijët tuaj, se çfarë bëjnë ata në internet. Ndërsa është më e vështirë t'i mbikëqyrësh ata drejtpërdrejt, vazhdoni të flisni me ta për çështje të internetit dhe ndani përvojat së bashku.
- Përforconi mesazhet e sigurisë dhe rregullat e automatizmit. Adoleshentët më të vegjël duhen kujtuar për nevojën e ruajtjes së privatësisë së tyre.
- Sigurohuni që adoleshentët të kuptojnë që postimi në lajme apo forume mund ta bëjë publike adresën e tyre të e-mailit.
- Sigurohuni që ju dhe fëmija juaj t'i kuptoni ligjet që lidhen me të drejtat e autorit, privatësinë, piraterinë, etj.

Pavarësisht përfitimeve arsimore dhe sociale që vijnë nga interneti, ekzistojnë rreziqe në lidhje me përdorimin e tij. Fëmijët dhe adoleshentët që e përdorin internetin mund të përballen me materiale që janë shqetësuese dhe të papërshtatshme. Përveç përdorimit të teknologjisë që përdoret për minimizimin e rrezikut, duhen përdorur edhe strategji të tjera si edukimi i fëmijëve në një moshë sa më të hershme për përfitimet dhe rreziqet e përdorimit të internetit. Është e nevojshme t'i udhëzojmë fëmijët si të bëhen të zgjuar dhe të përdorin internetin në një mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme.